



NIPT L41818014J

Adress: Rruga: "Gjik Kuqali",  
Hyrja kryesore Stadiumi Dinamo,  
Pallati I Ri, Kati II, Tiranë

## **RREGULLORE E BRENDSHME E AGJENCISË**

### **(Mbrojtja e të dhënave)**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Në mbështetje të Ligjit nr .9734, datë 14.5.2007, "Për Turizmin", të Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e Konsumatorëve" i ndryshuar, të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të Ligjit nr.9887, date 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe të VKM nr. 65, datë 21.1.2009, "Për kontratat e paketave të udhëtimit", Agjencia e Udhëtimit Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus) dhe aktiviteti i saj funksionojnë sipas rregullores së mëposhtme.

Kjo rregullore përbën një akt normativ, të detyrueshëm për administratorin, punonjësit e agjencisë si dhe për marrëdhëniet e agjencisë me partnerët e tjerë turistik ose joturistik.

Rregullorja paraqet në mënyrë shumë funksionale të drejtat dhe detyrimet e stafit dhe klientëve në kuadrin e plotësimit të detyrës së tyre për shërbimet e ofruara nga agjencia.

Kjo rregullore e brendshme ka për qëllim të japë informacion të plotë mbi llojshmërinë e shërbimeve që ne ofrojmë si dhe të mundësojë kryerjen e rezervimeve për destinacionet që klientët dëshirojnë. Përdorimi i shërbimeve tona, si në faqen e internetit apo dhe në zyrën tonë është subjekt i kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të poshtëpërmendura.

#### **Misioni dhe struktura e Agjencisë Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus)**

Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus) ka si mision të saj ofrimin e shërbimeve si paketa turistike në grup dhe individuale, shërbim transporti, shërbim biletarie si dhe oferta turistike të ndryshme me cilësi maksimale duke garantuar korrektësi dhe çmim konkurrues në treg.

Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus) përbëhet nga administrator i agjencisë, operatorët turistik, shoferët, cicëronët (shoqëruesit e guidave) dhe ekonomisti i brendshëm.

#### **Hyrje**

Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus) (më tej "agjencia") është operator turistik shqiptar që ofron pushime gjatë gjithë vitit. Kompania e mbështet punën e saj në një staf shumë profesional dhe me një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e shërbimeve.

Agjencia ka një rrjet të organizuar në 30 agjenci partnere udhëtimi në Shqipëri dhe ofron akomodim në më shumë se 100.000 hotele në të gjithë botën. Adresa e degës së agjencisë në Shqipëri:

Tiranë, Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus), Rruga: “Gjik Kuqali”, Hyrja kryesore Stadiumi Dinamo, Pallati i Ri, Kati II, Tiranë, Tel: +355699961122 / +355683333887.

## **1.Administratori, operatorët turistik dhe guida**

Administratori është oratk i vetëm i shoqërisë i cili duhet të përmbushi funksionet organizative të agjencisë. Është përgjegjësi kryesor për administrimin dhe mbarëvatjen e punës i cili siguron si më poshtë:

### **1.1.Masat për sigurinë e të dhënave personale**

1.1.1. Administratori ose operatori turistik merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale të klientëve nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

### **1.1.2 Administratori merr këto masa të veçanta sigurie:**

a) përcakton funksionet ndërmjet administratorit dhe operatorëve turistik për përdorimin e të dhënave;

b) përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të administratorit ose të operatorëve turistik të autorizuar;

c) udhëzon operatorët turistik, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe rregulloren e brendshme të agjencisë për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;

ç) ndalon hyrjen në mjediset e administratorit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;

d) hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar,

dh) ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;

e) vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;

ë) regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet etj.

1.1.3. Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit, pra me qëllimin e agjencisë. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përrjashtohet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një veprë penale.

1.1.4. Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar, për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muajsh nga data e nënshkrimit të deklaratës së pëlqimit të klientit.

## **2. Konfidencialiteti i të dhënave**

2.1. Administratori, operatorët turistik dhe guida, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

## **3. Mbrojtja e të dhënave**

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë”, “Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus)” deklaron si me poshtë:

### **3.1 Përkufizimi i termave**

Në këtë marrëveshje, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

“Agjenci”: Person juridik i regjistruar i cili kryen veprimtarinë e ofrimit, gjetjes dhe mundësimin të udhëtimit turistik, biletave të udhëtimit në mënyra të ndryshme transporti si dhe bileta për aktivitete sportive ose kulturore për klientët, në këmbim të pagesës.

### **3.2 Deklaratë mbi privatësinë**

3.2.1. “Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus)” (më tej “agjencia”) respekton rëndësinë e privatësisë së klientëve të saj. Kjo deklaratë përcakton bazën mbi të cilën mblidhen dhe përpunohen të dhënat e çdo klienti.

3.2.2. Të dhënat e mëposhtme të klientëve mblidhen nga faqja e internetit: a) Informacioni që klienti jep në mënyrë që të kryhet rezervimi i udhëtimit; b) Informacioni që klienti jep në mënyrë që të bëhet pjesë e një konkursi që reklamohet në faqen e internetit, kur plotëson një pyetsor ose kur raporton një problem; c) Detaje të transfertave bankare që klienti kryen për të përfunduar një rezervim; ç) Nëse klienti kontakton stafin e agjencisë, stafi mund të ruajë adresën e e-mail dhe të IP.

### **3.3. Ruajtja dhe transferimi i të dhënave**

3.3.1. Të dhënat e mbledhura nga agjencia mund të transferohen ose të ruhen në një vend jashtë Zonës Ekonomike Europiane. Gjithashtu, të dhënat mund të përpunohen nga stafi i hotelarisë ose mjeteve të transportit për të bërë të mundur udhëtimin dhe qëndrimin e klientit.

3.3.2. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga agjencia do të ruhen në serverat e sigurtë të “Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus)”.

3.3.3. Të dhënat e mbledhura nga agjencia mund të përdoren edhe nga agjencitë partnere të “Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus)”.

4.4. Të dhënat e mbledhura nga agjencia mund të përdoren për të informuar klientët mbi ofertat e ndryshme të agjencisë.

#### **4. Anullimi i përpunimit të të dhënave**

4.1. Klienti ka të drejtë të kërkojë nga agjencia të mos përpunojë të dhënat personale për qëllime marketingu, me anë të e-mail ose me anë të formularëve në faqen e internetit.

#### **5. Pëlqimi mbi mbrojtjen e të dhënave personale**

5.1 Duke vazhduar procedurën në faqet e internetit të “Matias Travel & Tours (Matias Travel Bus)”, klienti jep pëlqimin e tij mbi mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga ana e agjencisë, duke plotësuar deklaratën e pëlqimit.

Kjo rregullore do të shpërndahet të gjithë punonjësve të agjencisë dhe do të qëndroj e afishuar në ambientet e agjencisë dhe në faqen zyrtre të saj.

**ADMINISTRATORI**

**Erion Mane**